

ABSTRAKT

Hyrje: Sigurimi shëndetësor është një shërbim, apo një lloj mbulimi i sigurimeve që një person paguan për shpenzime mjekësore, kirurgjikale, e ndonjëherë dentare. Mungesa e një fondi për shëndetësi do të ishte handicap i madh për një shtet, e që do të shkaktonte pasoja të mëdha në atë vend.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi të masterit është të shqyrtojë gjendjen aktuale të sistemit të sigurimeve shëndetësore në Kosovë dhe të analizojë sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e këtij sistemi.

Metoda: Metoda e përdorur në këtë punim ishte një qasje e kombinuar metodologjike, duke integruar metodën krahasuese dhe atë përshkruese (deskriptive). Metoda krahasuese u përdor për të krahasuar sistemet e sigurimeve shëndetësore të Kosovës me ato të shteteve të tjera të rajonit, si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kroacia, ndërsa metoda deskriptive u aplikua për të përshkruar në detaje strukturën dhe funksionimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore në Kosovë.

Gjetjet: Në Kosovë ekziston një ligj për sigurime shëndetësore, ekziston një fond për shëndetësi, por përputhja e ligjit me fondit nuk janë të rregulluara aq mirë, prandaj edhe ka shumë sfida dhe mangësi në këtë aspekt.

Konkluzione: Buxheti i vogël në shëndetësi, ka ndikuar direkt në shërbimet shëndetësore, duke bërë që qytetarët gjatë marrjes së këtyre shërbimeve duhet të vetë-participojnë, e në rastet e rënda kur kostoja e këtyre shërbimeve është shumë e madhe dhe nuk mund të bëhet në Kosovë, ata janë të detyruar të grumbullojnë para në mënyra të ndryshme për tu trajtuar në qendrat shëndetësore në rajon ose në Evropë.

Rekomandime: Rekomandohet të krijohet Sistemi Informativ Shëndetësor, në mënyrë që të dihet saktë numri i personave që do të përfitojnë nga sigurimet shëndetësore; të rritet buxheti institucional për sektorin e shëndetësisë në mënyrë që të ofrohen shërbime më cilësore, më të shpejta, më efikase dhe me një kosto më të lirë se që ekziston sot. Po ashtu Ligji për sigurimet shëndetësore duhet të zbatohet në përpikëri sepse si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, legjislacioni në fuqi nuk zbatohet ashtu siç duhet.

Fjalët kyçe: sigurim shëndetësor, kontratë, ligj, buxhet, fond, rreziqe.